



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRIZREN/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRIZRENU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRIZREN

Nr. 19864/2011

GJYKATA KOMUNALE PER KUNDËRVAJTJE NE PRIZREN, me Gjyqtarin Gani Kastrati ,me procesmbajtësjen Mire Beqiraj në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit: Hasan Iljaz Hasani nga Prizreni rruga „ Ohri”, nr. 89, përshkak të kundërvajtjes nga neni 7, e lidhur me nenin 3 , të Ligjit nr. 04/L-050, për deklarimin, preardhjen, dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, preardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, dhe në bazë të nenit 195, të Ligjit kundërvajtjeve (“G.z. e Kosovës” nr.23/79)me 18.12.2012, merrë këtë:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET -procedura kundërvajtëse ndaj: Hasan Iljaz Hasani nga Prizreni rruga „ Ohri”, nr. 89, në bazë të nenit 198 al. 1 pika 8, të LMK-së, sepse nuk ka përgjegjësi kundërvajtëse, për kundërvajtjen për të cilën është i ngarkuar pasi Gjykates I ka prezentuar në shikim formularin e posaqem për deklarimin e pasurisë, me marrjen e detyres si zyrtarë I lartë publik, të vërtetuar gjatë procedimit të provave në seancën Gjyqësore.

Shpenzimet e procedurës bien në llogari të mjeteve buxhetore të kesaj Gjykate.

A R S Y E T I M

Me kërkesën e Agjensis kunder korrupsionit për deklarimin e pasurisë në Prishtinë me nr. 01-4099/2011, të dt. 24. 10.2011, është inicuar procedura kundërvajtjese kundër të paraqiturit: Hasan Iljaz Hasani nga Prizreni rruga „ Ohri”, nr. 89, përshkak të kundërvajtjes në veshtrim të nenit 7, e lidhur me nenin 3, të Ligjit nr. 04/L-050, për deklarimin, preardhjen, dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, preardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Gjykata me qellim të vertetimit te drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike ka ndegjuar dhe marrur në pyetje të pandehurin në seancën verbale të mbajtur me dt. 06.01.2012, I cili në mbrojtjen e tij kundërvajtjen për të cilën është i ngarkuar e kontestoi duke pohuar faktin se për vitin e kaluar 2011, e ka bërë deklarimin e pasurisë pranë agjensionit kunder korrupsion në Prishtinë , por thekson se dergimin e formularëve të mbushur e ka derguar me vones, për arsye se edhe me vones , I ka pranuar formularet për deklarimin e pasurisë për vitin e kaluar,thekson I paraqituri në deklaraten e tij duke pohuar edhe faktin se paraprakishtë nuk ka qenë I njoftuar me shkresën zyrtare me nr. 01/3717/2011, të dt. 26.09.2011, e cila shkresë është derguar nga AK, në kompanin regjionale „Eko regjioni”, në Prizren, pasi që I njejtë është pranuar si anëtarë I ri gjegjësishtë si kryesues I bordit të Drejtorëve në këtë kompani me dt. 01.05.2011, dhe që I njejtë nga „Eko Regjioni”- nga personat kompetent me këtë shkresë zyrtare nuk ka qenë I njoftuar për ta bërë deklarimin e pasurisë në pajtim me nenin 7, të Ligjit të sipërshenuar, por thekson I paraqituri se është njoftuar me shkresë zyrtare nga AKK, në Prishtinë me dt. 31.10.2011, sipas të cilët shkresë zyrtare I njejtë është njoftuar se duhet ta përmbushi formularin për deklarimin e pasurisë për qka edhe i njejtë ka përmbushur – respektuar obligimin duke e përmbushur formularet për deklarimin e pasurisë , sipas kërkesës së agjensis dhe këtë e ka bërë me dt. 18.11.2011, I cili faktë më së miri vërtetohet edhe nga fletkthesa, gjegjësishtë nga fletdorëzimi I nënshkruar dhe pranuar nga zyrtaret e AKK, në Prishtinë, ku një kopje e origjinalit të fletdorëzimit mbetet në shkresat e lëndës si provë materjale, si dhe I prezentoj Gjykates edhe shkresën zyrtare nga AKK, në Prishtinë të pranur me dt. 31.10.2011, provat të cilat janë bashkangjitur në shkresat e lëndës në bazë të së cilës vërtetohet se I paraqituri Hasan Hasani ka përmbushur obligimin e tij ligjor për deklarimin e pasurisë menjëher pasi ka pranuar shkresën zyrtare.

	Nr. Prot. 03-465/12 Dato: 28.12.2012
DPK/DMP	
02	

Poashtu I paraqituri I prezentoj Gjykates në shikim edhe kopjen e formularit për deklarimin e pasurisë të cilën ja ka derguar Agjensis kunder korrupsionit në Prishtinë të dt. 17.11.2011, I cili formularë është pranuar me dt. 18.11.2011, ku shifet k'jartë se I përmenduri ka bërë deklarimin e pasurisë, me marrjen e detyres conform nenit 7, të Ligjit të sipërshenuar dhe një kopje e formularit për deklarimin e pasurisë mbetet në shkresat e lëndes si provë materjale. Përfundimishtë thekson se pa fajin e tij, ka ardhur deri tek vonesa për deklarimin e pasurisë, andaj edhe I ka propozuar Gjykates që I njejtë të lirohet nga përgjegjësia kundërvajtëse.

Gjykata poashtu në cilësi të deshmitarit ka ndegjuar edhe parashtrusën e kërkesës –zyrtarin lartë në AKK-Prishtinë, Enis Sadikun, I cili në deshmin e tij ka përshkruar në tërsi rastin duke dhënë detajet përkitazi me veprimin e përshkruar në kërkesë ndaj të paraqiturit Hasan Hasani, por ka pohuar dhe faktin se I paraqituri nuk e ka përmbushur obligimin ligjor- nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë me pranimin e detyres sipas nenit 7, të ligjit nr. 04/L-050, edhe pse thekson se paraprakishtë është njoftuar kompania „Eko regjioni” në Prizren, lidhur me të rejat e fundit për zyrtarin e ri public I cili ka filluar punën në kompanin „Eko regjioni”, në Prizren, I cili sipas deshmis së tij thekson se Hasan Hasani ka filluar punën me dt. 01.05.2011, si kryesues I bordit të drejtorëve në „Eko regjion”, në Prizren, por thekson edhe faktin se I paraqituri Hasan Hasani, e ka përmbushur obligimin ligjor, gjegjësishtë ka bërë deklarimin e pasurisë me marrjen e detyres, por me vones janë derguar formularët për deklarimin e pasurisë dhe janë pranuar në AKK-Prishtinë, me dt. 21.11.2011, qka do të thotë sipas ushtruesit të kërkesës pas afati ligjor. Edhe pse në pytjen e gjyqtarit ushtruesi I kërkesës thekson se nuk është e rëndësishme për parashtrusën e kërkesës se I paraqituri a ka qenë me kohë apo jo I njoftuar nga Kompania „Eko regjioni”, lidhur me pranimin e formularëve për deklarimin e pasurisë, ngase sipas tij këtë njoftim ka qenë dasht ta bëjë pika kontaktuese pranë „Eko regjionit”, thekson parashtrusi në deklaratën e tij.

Gjykata gjatë vlerësimit dhe analizimit të shkresave në lëndë, kërkesës së organit, ku nga deshmitaria që I është bashkangjitur kesaj kërkesë shifet se anëtari I ri I kompanis regjionale për mbeturina „Eko regjioni”, në Prizren, Hasan Hasani, si kryesues I bordit është emruar me dt. 01.05.2011, që sipas ligjit në fuqi në atë kohë ka pasur afatë 60 ditë, për deklarimin e pasurisë, (të ligjit nr. 03/L-151, I cili ka qenë në fuqi gjatë asaj kohe), kurse ligji nr. 04/L-050, është shpallur me dt. 31.08.2011.

Gjykata pas administrimit të provave, shqyrtimit të kërkesës të inicuar nga parashtrusi I kërkesës, vetëm në bazë të dispozites materjale të nenit 7, të ligjit të sipërshenuar, I cili nenë parashih deklarimin e zyrtarëve të lartë public me rastin e marrjes së detyres, deklarates së të paraqiturit, provave të prezentuara në seancen Gjyqësore, dhe shkresave tjera në lëndë, vije në përfundim me konstatim se nuk ka prova se I përmenduri Hasan Hasani, ka kryer kundërvajtje për të cilën është I ngarkuar.

Ndaj në munges të provave Gjykata vendosi që ta **PEZULLOJ**, procedurën kundërvajtëse në bazë të nenit 198 al. 1 pika 8, të LMK-së.

Me sa është cekur mbi e sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRIZREN

Regj. 19864/2011

Me procesmbajtësen

Mire Beqiraj

Me dt. 18.12.2012

Gjyqtarin

Gani Kastrati

UDHEZIMI JURIDIK: Kunder këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa Gjykates se Lartë për kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh nëpërmes kesaj Gjykate.